



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

Nr. 35 Prot

Tiranë më, 21/01/2019

URDHËR

Në zbatim të shkresës Nr. 322 Prot, datë 14.01.2019 dhe VKM nr. 782, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”,

URDHËROJ

1. Fillimin e procesit zgjedhor për përzgjedhjen e tre kandidaturave përfaqësues të studentëve, të cilët do t'i propozohen Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e cila më pas do zgjedhë një prej këtyre kandidaturave të propozuara, si përfaqësues të saj në Bordin e Administrimit të ASA-së.
2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të vendosë në dispozicion të komisionit të zgjedhjeve ambientet dhe bazën materiale të nevojshme, për mirëfunksionimin e të gjithë procesit zgjedhor.
3. I gjithë dokumentacioni zgjedhor, duke filluar nga ky urdhër dhe deri në përfundim të procesit të zgjedhjeve, të ruhet në bazë të rregullave në kuadrin ligjor për administrimin, ruajtjen dhe arshivimin e dokumentacionit.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Komisioni Institucional Zgjedhor.
5. Ky urdhër, të shpallet në ambientet e ASA-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Marenglen Verli

